



## Terma Reference për:

### Koordinatorë

#### *Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri*

<b>Organizata:</b>	<b>Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri</b>
<b>Lloji i angazhimit:</b>	<b>Angazhim me kohë të plotë</b>
<b>Vendi:</b>	<b>Tiranë, Shqipëri</b>
<b>Mundësia e fillimit të punës</b>	<b>Qershor 2023</b>
<b>Kohëzgjatja e pozicionit</b>	<b>1 vit (me mundësi kohëzgjatjeje)</b>
<b>Afati i fundit i aplikimit</b>	<b>25 maj 2023</b>

### Informacion mbi AWEN

#### ***Kush jemi***

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) është krijuar më 1 korrik 2009 (dhe regjistruar më 27 dhjetor 2011) si nismë e tetë organizatave jo-fitimprurëse të fokusuara në mbrojtjen e grave, me mbështetjen fillestare të Fondacionit Kvinna till Kvinna. Rrjeti ynë synon të forcojë bashkëpunimin ndërmjet organizatave për të rritur ndikimin e nismave të përbashkëta në nivel kombëtar dhe për të fuqizuar lëvizjen feministe në Shqipëri.

Aktualisht rrjeti përbëhet nga 10 organizata të grave nga rajone të ndryshme të Shqipërisë, të cilat janë: Shoqata “Gruaja, Paqja dhe Siguria” (Durrës); “Unë, gruaja” (Pogradec); “Agritra Vision” (Peshkopi); Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (Tiranë); “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza” (Tiranë); “Qendra për Nisma Ligjore” (Tiranë); “Gruaja tek Gruaja” (Shkodër); “Forumi i Gruas Elbasan” (Elbasan); “Qendra Psiko-Sociale Vatra” (Vlorë); “Jona” (Sarandë).

#### ***Informacion i përgjithshëm***

Rrjeti ynë punon për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sidomos të drejtave të grave dhe vajzave, duke synuar fuqizimin social, ekonomik, kulturor dhe politik të tyre. Ne i arrijmë qëllimet tona përmes avokimit të përbashkët në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe lokal, duke rritur ndërgjegjësimin, monitorimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për të përmbushur detyrimet e tyre sipas legjislacionit kombëtar dhe konventave ndërkombëtare,



duke kryer kërkime për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut të grave, duke shërbyer si një forum për të ndarë njohuri dhe shkëmbyer praktika, si një lehtësues për zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve, si dhe menaxhimin e granteve për anëtarët e rrjetit dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile.

Fushat tona kryesore tematike janë: Reduktimi i Dhunës me Bazë Gjinore duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore; Pjesëmarrja e grave në politikë; Fuqizimi ekonomik i grave; Mbështetja e OSHC-ve të grave që të bëhen më demokratike, të qëndrueshme, të angazhuara për mjedisin dhe efikase në realizimin e misioneve të tyre.

AWEN gjatë vitit 2023 synon të vazhdojë punën për fuqizimin, rritjen e vizibilitetit dhe qëndrueshmërisë ndaj të drejtave të vajzave dhe grave. Për këtë arsye, kërkohet të punësojmë një Koordinatorë, që do të ndihmojë për të arritur qëllimet dhe objektivat e organizatës.

#### **Kualifikimet dhe përvoja e nevojshme:**

- Diplomë Universitare, e preferueshme në shkencat sociale, juridike, shkencat politike, etj.
- Aftësi dhe eksperiencë të mëparshme në shkrimet e Projekt Propozimeve
- 3-5 vite në menaxhimin e projekteve, planifikimin dhe zbatimin, familjaritet me projektet e zhvillimit të financuara nga donatorët
- Përvojë të mëparshme në nisma advokuese dhe/ose aktivitete në lidhje me barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut
- Përvojë në projektet e zhvillimit dhe eksperiencë në menaxhimin e projekteve, duke përfshirë edhe përvojë të qëndrueshme në menaxhimin e ndryshimeve
- Aftësi në përgatitje/shkrim raportesh
- Përvojë në monitorim dhe vlerësim projektesh
- Komunikim i shkëlqyer dhe aftësi bashkëpunimi në grup dhe në rrjet
- Aftësi të forta analitike, komunikimi me gojë dhe me shkrim dhe aftësi të punës/ndërtimit të ekipit
- Niveli i shkëlqyer i gjuhës shqipe dhe angleze, në të shkruar dhe të folur

#### **Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorës:**

##### ***Përgjegjësitë kryesore :***

- Menaxhimi i aktiviteteve të projekteve, planet e punës dhe buxhetet bazuar në rezultatet e pritshme të projekteve dhe objektivave afatgjatë
- Monitorimin në vazhdimësi të aktiviteteve të projekteve
- Kryerja e vlerësimit të brendshëm të projekteve, në bashkëpunim me stafin dhe anëtarët e rrjetit
- Mbajtja e komunikimit të ngushtë me anëtarët e AWEN si edhe organizata të tjera të mundshme përfituese, në zbatimin e projekteve



- Mbajtja e komunikimit të rregullt me personelin e AWEN
- Të mbështesë nismat për avokim të AWEN dhe ato që lidhen ngushtë me aktivitetet avokuese
- Ofrimi i asistencës teknike për organizatat anëtare në avokim dhe lobim
- Ofrimi i asistencës teknike për organizatat anëtare në monitorim dhe vlerësim, në bashkëpunim me personelin tjetër të projektit
- Zhvillon dhe menaxhon kontaktet kryesore, marrëdhëniet dhe partneritetet me anëtarët e rrjetit, ofruesit e shërbimeve, organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë
- Të marrë pjesë në takime, të raportojë të dhënat e vlerësimit të grupeve përkatëse, dhe të jetë një zë i fuqishëm në takimet e grupeve të interesit, për më shumë ndihmë kur është e nevojshme
- Të përgatisë dhe përditësojë planet e punës vjetore dhe tremujore, dhe t'i paraqesë ato për marrëveshje dhe miratim
- Të japë këshillim teknik për përfituesit e projekteve, të rishikojë raportet dhe të monitorojë aktivitetet e kryera nga palët përgjegjëse
- Të sigurojë dorëzimin në kohë të planeve të punës, raportet, rezultatet e punës dhe konkluzionet e tjera të projektit për rishikim dhe vlerësim, sipas nevojave
- Raporton drejtpërdrejtë tek Drejtori Ekzekutiv dhe Bordi Drejtues

***Ky përshkrim pune paraqet vetëm qëllimin e përgjithshëm të aktivitetit, detyrat dhe përgjegjësitë themelore të lidhura me këtë pozicion. Këto terma mund të plotësohen me një përkufizim më të detajuar të detyrave, përgjegjësisve dhe planit të punës dhe është subjekt për të ndryshuar me mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të stafit menaxhues.***

#### **Procedura e aplikimit**

Dërgoni dokumentet e mëposhtme me e-mail në:

[info@awenetwork.org](mailto:info@awenetwork.org) dhe [teuta.dedej@awenetwork.org](mailto:teuta.dedej@awenetwork.org)

- Curriculum Vitae
- Letër Interesi
- Dokumente të tjera që vërtetojnë eksperiencat dhe kualifikimet tuaja të mëparshme të punës

Dokumentet duhet të dërgohen jo më vonë se data **25 maj 2023**.

*\*Sqarim për përzgjedhjen e kandidatëve: Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë, do të ftohen për intervistë. Nëse nuk keni marrë një email konfirmues, në listën e ngushtë deri më 25 maj 2023, nuk jeni përzgjedhur për shqyrtim të mëtejshëm në këtë pozicion.*